

VENDIM
Nr. 73, datë 16.5.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “CGC” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 4 pikat 50, 107, të nenit 22 pika 2 germa “ç”, të nenit 83 pika 1, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, nenit 4, pika 1, germa “ç”; nenit 10 dhe 11 të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.5.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “CGC” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit të shoqërisë “CGC” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) janë plotësuar në mënyre korrekte.
- Dokumentacioni ligjor (neni 9, pika 1, germa “d/i”, “d/ii”) (akti i regjistrimit dhe struktura organizative) janë plotësuar në mënyre korrekte,
- Germa “e/vii” (garanci e performancës) është plotësuar.
- Dokumentacioni specifik për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa “e/i”, “e/ii”, sasia e gazit në Nm³ dhe garancia e cilësisë së gazit) janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentet specifike për llojin e licencës (neni 9 pika 2 germa “e/iii” garancia financiare) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë CGC sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti